

VENDIM
Nr. 26, datë 9.3.2016

PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË KESH SHA PËR SHTYRJEN E AFATIT TË MARRËVESHJES PËR SHITBLERJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE MIDIS KESH SHA DHE OSHEE SHA PËR TEPRICAT E ENERGJISË ELEKTRIKE, PËRFSHIRË TEPRICAT NË KUSHTET E PRURJEVE TË MËDHA, ME QËLLIM PLOTËSIMIN E HUMBJEVE NË RRJETIN E SHPËRNDARJES PËR VITIN 2015

Në mbështetje të nenit 16, 108, 109, pika 5, 110, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenit 26 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin të Bordit të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.3.2016, pasi u njoh me kërkesën e shoqërisë KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a., për miratimin e amendimit të marrëveshjes për shitblerjen e energjisë elektrike midis KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a., për tepricat e energjisë elektrike, përfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha, me qëllim plotësimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2015, si dhe relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike të ERE-s,

konstatoi se:

- KESH sh.a. është e licencuar për aktivitetin e furnizuesit publik me shumicë të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 10, datë 6.2.2014.

- OSHEE sh.a. është e licencuar për aktivitetin e furnizuesit publik me pakicë të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 97, datë 27.10.2014.

- KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a. kanë lidhur në datën 6.2.2015, marrëveshjen për shitblerjen e energjisë elektrike midis KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a., për tepricat e energjisë elektrike, përfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha, me qëllim plotësimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2015.

- Palët kanë nënshkruar bashkërisht amendimin e nenit 7 të marrëveshjes, për shtyrjen e afatit të saj deri më 30.6.2016.

- Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, hidhen bazat për krijimin e një modeli të ri të tregut të energjisë elektrike dhe marrëdhënieve që do të vendosen midis pjesëmarrësve në këtë treg dhe në sektorin elektroenergjitik. Ky ligj parashikon një sërë aktesh nënligjore dhe rregullatore që duhet të miratohen (përcaktim i nenit 108) brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi, për të siguruar zbatimin e plotë të tij; po ashtu në kuptim të nenit 109, pika 5, detyrimet ekzistuese të pjesëmarrësve të tregut do të vazhdojnë të përmbushen nga ana e tyre deri në miratimin e akteve nënligjore, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e shtyrjes së afatit të marrëveshjes për shitblerjen e energjisë elektrike midis KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a., për tepricat e energjisë elektrike, përfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha, me qëllim plotësimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2015, deri më 30.6.2016.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë të licencuarit KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrinë efektet nga data 1 janar 2016 – 30 qershor 2016.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti